

## INTERVISTË ME MUSA DOBRUNËN

Prishtinë | Data: 29 prill dhe 8 maj 2015

Kohëzgjatja: 182 minuta

Të pranishëm:

1. Musa Dobruna (I intervistuari)
2. Jeta Rexha (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)
4. Hydajete Dobruna (Shoqja e të intervistuarit)
5. Pranvera Dobruna (Bija e të intervistuarit)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

() - komunikim emocional

{ } - e intervistuar shpjegon me gjeste

*Simbole të tjera në transkriptë:*

[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Jeta Rexha:** Zotni Musa, ju lus me u prezentu' nihere, edhe me vazhdu' me na tregu' diçka për fmininë tuj.

**Musa Dobruna:** Po, quhem Musa Qazim Dobruna, emrin e babës kuptohet. Biri i Qazimit dhe Shefkijes. Prindërit e mi kanë qenë familje pasanike, mund t'them edhe shumë t'pasuna. Por që shpejt, mas kapitullimit të Jugosllavisë Mbretnore, janë varfëru' deri në shkallën ma t'ulët t'mundshme, dhe osht' dashtë që kafshatën e bukës ta sigurojmë n'mënyrë t'ndryshme. Baba im, për shkak të jetës së pasun që ka pasë n'rininë e hershme dhe deri në vitet e martesës, nuk është marrë me ndonji zeje, ose nuk e ka ni nevojën si duket – përshtypja ime osht' e tillë. Dhe, ka mbetë që n'ditët e varfnisë m'e gjetë ngushëllim në pije. Herë, herë ka qenë deri n'delirium, ate e ka bo për... edhe nga mllefi që ka pasë atëherë ndaj regjimit të Jugosllavisë Mbretnore.

Sidomos, osht' për t'u thonë rasti i kthimit të tinit nga një fshat i Gjakovës me kerr e kuaj dhe ndalet në qendër të qytetit. Një grup ushtarësh me një atëhere, fotograf qysh t'dush me i thonë, ka qenë një kamerë speciale, e kanë bo një dokumentar, e ai dokumentar gjendet në Kinotekën Jugosllave. Skenari – tu e rrëmby pushkën e ushtarit jugosllav dhe tu iu drejtu' atyne, ndërsa gazetari francez ka inçizu' edhe ka marrë ka bo fotografi. Nji here kom pasë rastin m'e pa një dokumentar që jipej në kinemanë e Gjakovës n'atë kohë. Por, mas Luftës së Dytë Botnore për m'e tregu... qëllimi ka qenë për me tregu' egërsinë tonë ndaj ashtu... dhe me arsyetu' masat, mas Kongresit të Versajës. Dihet krejt çka ka ndodhë. E masa kryesore e para ka qenë varfërimi i familjeve të mëdha, gjithandej nëpër Kosovë, e tash po flas për Gjakovën.

Gjyshi ka qenë shok i ngushtë, do t'thoja mik n'pikëpamje t'afrimit t'kontakteve me Hasanin e Jakup Ferrit, asaj familjes të famshme të veriut të Shipërisë në Mal të Zi, Plavën e Gusinë. Edhe kumar e ka pasë Hasan Jakup Ferrin që ndryshe i kanë thonë Hasi i Jakup Ferrit, qe gjyshi i Rexhep Ferrit akademikut. Ata kanë bo konak n'kullën tonë n'Gjakovë, e ma vonë n'ditët e rinisë pak sa ma t'vjetër, vjen koha e martesës. Dhe, ndodhë atëhere kur regjimi monarko-fashist do t'i kisha thonë, i Karagjorgjeviçëve. Ka zbatu' Reformën Agrare sipas projekteve serbe, nuk po i përmend, nuk jam historian. Kreatorët e atyne projekteve. Por di që n'atë kohë qeveria e Pashiçit e ka zbatu' Reformën Agrare dhe neve sikundër të gjitha familjet e mëdha n'Kosovë na ka lonë pa toka. Familjes tonë i ka lonë aq sa duhet për me majtë ekzistencën, të cilën osht' deshtë copa-copa me e shitë, parcela-parcela për me pagu' taksat e asaj kohe, tatimin. Që ka ndodhë, edhe n'kohën kur unë jom bo me ditë edhe me pa që n'praninë e dëshmitarëve me nënshkru' fletëzen se e ka marrë kërkesën për pagesën e tatimeve e ka nënshkru'. Po shumë shpejt osht' deshtë me shku' në organet e pushtetit atëhere, me deklarë pse s'e ka pagu' t'gjithë tatimin (qeshë). Se do t'thotë ia kanë futë noj letër atje, gjysmën ose një pjesë e ka pagu', ai e ka pagu' krejt por...

Kjo ka shkaktu' pastaj rrëmbimin e pasunisë. Dhe, osht' marrë toka në të cilën edhe sot ekzistojnë objektet, për shembull t'kooperativës bujqësore në Skivjan dhe objekteve përcjellëse t'asajna. Edhe një ambullancë dhe një godinë administrative, të gjitha kto kanë shërby për shëndetësi, tregti, shkollë, kulturë

përgjithësisht, por në tokën tonë. Nuk ka zgjatë shumë dhe tokën që e kemi punu' vet, çifçija që ka punu' një kohë aty e ka marrë e ka regjistru' si t'veten edhe ne mo nuk kemi pasë çasje aty. Kshtu kemi metë pa... kemi jetu' në rrogë me mëditje ku osht' shitë baba jem për me majtë familjen. Kjo ka qenë shumë e dhembshme. Maj n'men ditë pa bukë. Po kjo ka qenë qëllimi i Jugosllavisë Mbretnore.

Atëherë gjet rrugë me dalë edhe me u marrë me shpekullim t'i themi. Me dalë n'Shipni me marrë duhan, me shitë ktu, me shitë dhe ka shfrytëzu' që prej andej ka sjellë libra, ka sjellë voj trandofili, ka sjellë edhe gjana tjera. Edhe porosi prej andej, aktivitetin nacional-kombëtar. Dhe, rasti p'i themi tragjik, po ishte edhe tragjik ndodhë që karavani me libra, duha, e voj trandofili, në vjeshtë e vonë të vitit 1937 rrethohet shtëpia jonë. Dhe jo vetëm shtëpia jonë, por rruga e Çabratit prej mahallës t'Hamkës qysh i thonë e deri në mahallën e Mulla Jusufit. Hyjnë xhandarmëria dhe policia që e runte qytetin, që e mante rendin n'qytet, dhe t'uniformumt, financierë t'uniformum, bajoneta, i majshin kshtu ato bajonetat {tregon me duar}. Kontrollunë n'shpi, por nuk gjetën gja për shkak se karavani ka mri diku një qind metra para se me hy n'terrenin e shtëpisë ku banonin, dhe vritet prijësi i karavanit. Të tjerët ikin, por nuk mrrijnë me ra n'dorë të xhandarmërisë të atëhershme. M'kujtohet Shpend Halili, një malësor burrë i pashëm, që erdh mas disa ditëve me e pa babën masi e lirun prej burgut. Një javë e kanë torturu' siç dinin ata. Ka ndodhë edhe në shytimin, me i ra shuplaka kshtu, {tregon me duar} kur ia kom çu shtrojën mbulojë.

Burgu gjindej te Ura e Islam Begut n'Gjakovë, ajo urë mo fatkeqësisht nuk ekziston mo n'formën e çfare e ka pasë. Tash ajo gjindet veç një pikturë në zyrën e Shoqatës së Luftëtarëve t'Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare në Gjakovë. Ka edhe të tjera...

Që jom unë n'fillim të Çarshisë s'Madhe të Gjakovës. Afër kullës që edhe sot ekziston, osht' muzeu s'e di me siguri a osht' muzeu muze etnografik, apo kshtu historik në pjesën e vjetër të qytetit, afër dy tyrbeve. Osht' e Eminit dhe një tyrbe tjetër të cilës nuk ia di emrin e që osht' ma e vjetër se Teqja e Sheh Eminit. Sheh Emini ka qenë njeri i shkolluar, ka qenë arkitekt n'kohën e Turqisë. Ka projektu' objektin e shpisë t'vet, tyrbes edhe teqes, ajo ekziston edhe sot. Aty mo nuk ekziston xhamia n'krye t'pazarit, që osht' rrzu' mas Luftës së Dytë Botnore. Nuk e di, mund të... Ashtu sikundër edhe Xhamia e Islam Begut, që ka qenë para se të hyjsh, t'a prekësh Urën e Islam Begut, ka qenë Xhamia e Islam Begut mu në qendër. Edhe ajo e ka një histori t'posaçme për t'cilën e kom vetëm një detal. Siç ndodhë edhe sot edhe atëherë hoxha, mbajshin, predikonin ato çka atyne iu intereson, religjionin. Kanë qenë dy hoxhë t'shkolluar – Hafiz Guta dhe Bajram Mulla Agani. Bajram Mulla Agani ka qenë axha i Fehmi Aganit, gjyshi i ministrit aktual i shëndetësisë edhe... tash nuk e di për çka përgjigjet.

Ndodhi me 21 mars 1942. Baba im solli ushqim për me bo një sillë, për musafirët që do t'vinin, dhe pjesën tjetër për teqe. E ka pasë rendin me e çu ushqimin. Nona ime ka qenë gru e fortë, dhe i tha, "Unë sot me krahë të... gusës {lëvizë duart}, të themi ne, " e fshij magjen për me bo pak kuleqë për fmitë". Do t'thotë s'ke mill n'magje. "E ti, kto...", "Mori, merre e ta përgatitë ti!". E tash n'qat "mori", i thotë ajo, "Kqyre njeri," se burri nuk thirrej në emër (qeshë). "Kqyr njeri," tha "Zoti edhe teqja i kemi qita që jemi bo sepse e që i kemi qitë n'dyje". Bash qito fjalë, po i them n'mënyrë besnike. Prapë baba im e ngriti zanin pak, si burrat që ishin atëhere dhe gjithë idhnim doli. U kthy masi u bonë gati kto bashkë me shokun. Me një njeri aty, i bajti ato, i ka çu n'teqe, musafirët pritshin, i ka dorëzu' aty dhe babai - baba quhet ai i teqeve t'Bektashijve, quhej baba Hamëz – njeri që e ka shëtitë botën. Edhe i thotë "Shka ki biri im?", se e sheh prej shprehjes se nuk osht' Qazimi i djeshëm, po diçka tjetër (qeshë). Dhe "Jo kurgjo..", "Fol" tha. "Po pata pak telashe me Shefkijen," se edhe ajo ka qenë Bektashi. "Pse?", tha "Qështu...", "Po ka ajo t'drejtë. Ajo ka të drejtë. S'pari fmijve, e ktu çka t'teprojnë".

Dhe e qetëson babën, vjen baba, fillon tash pija. Shërbejsha unë por edhe nana. Flitshin për Lëvizjen Antifashiste Nacional-Çlirimtare, kjo ndodhë mas demonstratave antifashiste që jonë bo n'Gjakovë. "Po a

din bre Sadik,” i thotë baba “që edhe sot kur bie shi ose o’ vront, mu m’dhamin brijtë prej rrahjeve që i kom pësu’ prej xhandarmërisë?” Tha, “Po, pak ka njerëz që nuk i kanë pësu’, por maje n’mend çka po t’them, n’qit luftë që po hyjmë do ta fitojmë ç’çaz”. Morrën të tretë gotat edhe i çunë {bën sikur po pin}. Por, t’u e çu gotën Sadiku mendoi me za edhe tha, “Masanej...”, tu e çu gotën “E masandej...”. E çunë gotën, baba thotë, “Mirë Sadik, po çka ke qajo ‘masanej’?”. Qikjo ka rëndësi t’madhe tash, mund ta shkëputni kte, ka rëndësi shumë t’madhe. “Masanej,” thotë “do t’ia nisim edhe një luftë tjetër të cilën gjithashtu do ta fitojmë, por me mundim ma t’madh”. Osht’ lufta e fundit që përfundoi. “Mo, bre Qazim... ti Sadik, edhe i luftë a?”. “Po, {pohon me kokë} gjithashtu do ta fitojmë!” Sadik Tafarshiku mas Luftës së Dytë Botnore, si antifashist që ishte, e bonë udhëheqës të Punëve Botnore. A e din çka jonë Punët Botërore? Punët komunale banesore atëhere quheshin Punë Botërore. Shumë shpejt mas ksaj ai ra n’burg. I man... nuk e di sa vjet burg, por mas burgut angazhimi i tij ka qenë shpërndamja e librit në çdo fshat t’Kosovës. Ka vdekë vonë, dhe sot Bibloteka në Ferizaj mban emrin “Sadik Tafarshiku”.

Baba im ka pasë edhe një shok tjetër. Ai ka qenë t’i themi me gjuhën e përparshme *hafini*, ose shpiun (qeshë), n’kohën e Turqisë, n’kohën e Austrisë, qato pak ditë sa ka zgjatë Lufta e Parë Botnore, n’kohën e Jugosllavisë Mbretnore, n’kohën e fashizmit (qeshë), dhe mas Luftës së Dytë Botnore bashkëpunor i Shërbimit të Sigurimit Shtetënor Jugosllav. Ka vdekë në Romë si imam i xhamisë së Romës. Dhondër i Shitave, burri i hallës t’Vehap Shitës (buzëqeshë), i cili e ka hekë prej listës Vehap Shitës që ka qenë n’burgun ku sot gjindet gjyqi i Prishtinës. Gjyqi Komunal, aty ku ka zhvillu’ veprimtarinë “Rilindja” deri vonë, shpija botuse “Rilindja”. Dhe në vend t’tij osht’ hy n’listë Fahri Hoxha të cilin e kanë varë me 28 gusht 1944 së bashku me Ganimete Tërbeshin. Dhe, një a dy malazeze tjera, gjithësej dhetë jonë varë. Qikjo osht’ vetëm një episod i asaj pjese të rezistencës antifashiste deri n’qat moment.

Aktiviteti ka vazhdu’ pandërpre. Unë kam qenë i kyçun si mbajtës i lidhjeve në mes të udhëheqësisë së partisë dhe të gjitha familjeve që kanë përqafu’ Lëvizjen Antifashiste Nacional-Çlirimtare, gjithë andej Gjakovës, komplet Gjakovës. Jonë shumë familje, unë kom diku t’rejistrume rreth tre qind, ma saktë i kom 316 familje me t’cilët unë kom mbajtë lidhjen në mes të Hamdi Shehut, ma vonë në mes të Safete Nimonës, që ka pasë nofken ‘Guseva’ edhe ma vonë mas kompromitimit, e ndërroi nofken në ‘Lule’. Ajo edhe ka fletë n’shi tonë, s’bashku me një malazeze që e ka pasë nofken ‘Fatime’. Të dyjat te ne, edhe Nazmije Nimani e treta ishte, vijke me feregje. Deri n’komprometimin e tyre, edhe dalën në hallall.

Ka qenë e vështirë ajo kohë. Unë kom pasë bashkëpunorë t’ngushtë Fehmi Aganin, ndjesë pastë; Sami Bashotën, ndjesë pastë ka vdekë në Finlandë, edhe me urdhën t’tij e kemi vorrosë n’Gjakovë. Ka qenë i persekutim mas Luftës së Dytë Botnore për idetë e tij kombëtare. Si msimdhanës ka afirmu figurat e kulturës, tu e përfshi edhe Fishtën e ndalumë dhe shkrimtarë tjerë të ndalumë. Osht’ marrë shumë shpesh në biseda informative, dhe dihet si kanë përfundu’ ato. N’fund osht’ deshtë t’a braktisë vendin edhe të shkojë jashtë ku ka përfundu’ jeta e tij në mënyrë... vetëm ai e din. Kom pasë edhe shumë shokë të tjerë për biografinë e t’cilëve nuk du t’flas për shkak të devijimeve që kanë pasë me rastin e marrjes në biseda informative të njerëzve që kanë rënë n’konflikt me idetë e atëhershme.

Në familje kemi rreth 37 vjet burg, jo për ndonji veprim kshtu fizik, t’i themi, kundër regjimit, përveç vllaut t’fundit i cili i zhgënjym tejmasë, masi e ka nxerrë prej pune ka shku’ ka bo një mollotov dhe ia ka flugë Komitetit n’vitin 1984 – Komitetit t’Gjakovës. Për ate osht’ dënu’ 14 vjet burg. Dhe mandej kur ka ardhë koha ka shku’ n’UÇK, bashkë edhe me njimdhetë tonë, t’familjes tonë. Ndër ta ka qenë edhe Sokoli. Osht’ njëri prej 30 të udhëheqësisë ma t’nalltë të UÇK-së si prokuror ushtarak. Mund ta keni pa ndoshta në Klan. Nuk ka pranë t’pasunohet si shumica e tjerëve që i kanë shfrytëzu’ pasuninë e ktij vendi të shumë-vujtun për interesat personale. Ai sot shfrytëzon banesën e tij që e ka marrë si luftëtar i Lëvizjes Antifashiste Nacional-Çlirimtare, dhe për meritat se kam qenë partizani ma i ri, pa i mushë t’14-tat {pohon me kokë}... kjo osht’ epizod tjetër tash (qeshë).

## Pjesa e Dytë

Përkundër historiografisë serbe, thuhet se rreth 1400 familje serbe janë shpërngulë prej këndeje, prej Rrafshit t'Kosovës dhe Dukagjinit. Pjesa dërmuse e popullatës janë shqiptarë me origjinë ortodokse, t'paktën vetë, gjatë ktyne viteve mas luftës t'fundit t'UÇK-së ke rreth 30 kisha janë t'zbulume nëpër Kosovë. N'qat kohë prej fshatit prej kah mbaj emrin Dobruna, janë shpërngulë përveç tjerëve, tre vllazën t'ni familje. Njeni o' nalë në Gjakovë, njo në Shtime, tjetri ka shku' n'Turqi. Me ate të Turqisë, gjyshi edhe baba im, kanë pasë lidhje deri n'vitin 1937, '36, jo '37... '36. Une e maj n'men musafirin e lartë që e kemi tash t'çmushëm nga lart... n'vitin 1936. Mandej osht' ndërpre çdo lidhje, çdo kontakt me ta.

Familja e Shtimës, unë duhet të besoj se osht' familja prej nga del Hajredin Hoxha, profesor Hajredin Hoxha. Ai ka dhanë sociologji në Fakultetin Filozofik t'Prishtinës deri në vdekjen e tij në Greqi. Ai ka pasë guximin që në një simpozium që osht' majtë në Novi Sad, me thonë se Serbia nuk ka shliku Kosovën siç pretendon historiografia e serbe. Por thotë, "Serbia e ka okopu' Kosovën" – që ka qenë guxim i madh me thonë n'vitet '70-ta. Ka qenë guxim i madh por ai e ka thonë. E ka thonë edhe për arsye se ka qenë i afirmum si profesor dhe, ata e kanë thirrë n'biseda informative gjithmonë qysh ka ndodhë me njerëz tanë nga ana e organeve t'shtetit, organeve të dhunës fizike. Qikjo osht' ajo.

Dhe, t'parët e mi kanë marrë toka sa kanë deshtë, Skivjan, Dujakë, tri kilometra përmes lumit. Mos me iu lutë Zotit a po bjen shi a jo. Ujë ka pasë, toka e mirë, tona t'mirat. Kanë marrë një pjesë të Bella Cërkës afër i bije kjo pjesa kah Rahoveci. E kanë marrë një fshat që quhet Ujëz, afër Gjakovës, i bje afër mbi Urën e Shenjtë në t'djathë kah t'shkojsh për Prizren. Fshati Dol afër Gjakovës gjithashtu edhe aktualisht ne me tapia e kemi mbi 13 hektar tokë e pyje. Oseki i pashës afër Gjakovës, Skivjani, Baballoqi, Shishmuni i Rrafshit, dhe Raça e Moglica. Do t'thotë, e shprehur sipas... zhargonit t'vjetër, kemi qenë një lloj feudalë, kemi qenë feudalë (buzëqeshë). Kemi pasë feudet tona dhe ka ndodhë ajo ana pozitive e familjes sonë që i kemi pranuar si çifçijë fshatarët prej Malsisë së Gjakovës, dhe kurrë me ta nuk kemi bo kontratë. Rregull e shkruame edhe e pashkrume ka qenë, n'qoftëse kontrata nuk përsëritet n'krye t'tri vjete, toka bohet e tyne. Unë e vlerësoj si akt pozitiv.

Familje e Haxhi Hoxhëve, pasardhës osht' Fadil Hoxha... prej t'njejtit fshat osht'. Familja e Dolshëve n'Gjakovë gjithashtu janë prej t'njejtit fshat. Familja e Spahijve t'Gjakovës gjithashtu prej t'njejtit fshat. Manej osht' një familje që e ka emrin Zarari (qeshë). A e din fjala zarrar çka e ka kuptimin?

**Jeta Rexha:** Sherr? A osht' sherr?

**Musa Dobruna:** Jo! Zarrar osht' humbës (qeshë). Falimentus, osht' marrë me diçka me aktivitet ekonomik, ose ka dështu'. Ose si tash që ndodhë, ka falimentu', ashtu zarrar. Dhe janë edhe do familje tjera, po kryesisht, kto familje janë të t'njejtit fshat. Kom pasë fatin n'2003-shin... n'2013-shin me shku' me pa, janë anë t'bukura, po duhet dora e njeriut me i punu'. Ka dy liqejë t'vegjël dhe një luginë përtej kufirit, do t'thotë në anën e shtetit shqiptar atje. Fmitë e tyne, shkollohen në anën tonë në shkollën e Dolit... e Godenit. Ja... kshtu (buzëqeshë).

Masnej për të tjerat, mas përqafimit të idesë së Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare baba im si bektashi, dhe gjithë sektit i bektashijve ka qenë në Lëvizje. Dhe siç e përmenda Sadik Tafarshiku ka qenë nationalist i paepur, dhe i tillë ka vdekë, por që ka lexu' shumë. Dhe, mas burgut që e kanë mbajtë osht' bo aktivizet për përhapjen e librit shqip dhe siç thonte ai, "M'ka metë vetëm maja e Lubotenit pa e çu një libër" (buzëqeshë). Një shembull të tij, si lexis, si i apasionum, e lexon Vilhelm Vajtlingun me titull serbisht, "Harmonije, Garantije i Slobode" – "Harmonitë, Garanca dhe Liria", dhe "Liritë", propagator i paepur i ideve të Marksit. Dhe, t'u folë për çashtjen e barazisë n'mes njerëzve, osht' shok i ngushtë i Llasallit. Nuk i

keni lexu' ju kto sene. I përkasin pjesës së marksizmit. Llasalli osht' një gjermon dhe një entuziazist që t'u folë për barazinë e plotë n' mes njerëzve don me ndihmu' marksizmin dhe lëvizjen punëtore ndërkombëtare me idetë e Marksit. Dhe, shkrun në kohën e tij, një gazetë gjermanve për barazinë e plotë të njerëzve. Kjo ka randësi edhe sot për njerëzit, se nuk ekziston një jetë e një njeriut – barazia e plotë, kishte me qenë e panatyrshme.

Të nesërmen del Engelsi dhe thotë në një artikull "Llasalli, i ka bo një shërbim t'keq Lëvizjes Komuniste Ndërkombëtare, për shkak se nuk mund të ketë barazi t'plotë mes njerëzve. Por, barazi të plotë para ligjit". Nuk mund të ketë barazi të plotë në mes meje që kom hy në moshën e katërt, dhe t'riut që mundet mrena ditës me gropu' këtë, me e rregullu' {dëfton nga oborri}, e unë nuk mundem as dy here me i ra asaj (qeshë). Dhe me marrë t'mirat materiale t'ekzistencës njisoj si ai, si une. Nevojat e tij për ekzistencë për ushqime, për kto sene janë shumëfish ma t'mëdha se për mu. Dhe me marrë prej shoqnisë baraz si ai, si unë, nuk bon. A o' qashtu? Unë nuk mund t'kërkoj, osht' e panatyrshme me kërku' me pasë rrogën e një ministri. Pa marrë parasysh kontributin që mundem m'e dhanë, se ai ka detyra shumë të mëdha për këtë popull. A o' qashtu? Ju për shembull keni shumë detyra dhe merita që e kryni këtë detyrë. Kontributi im osht'... veç, por kontributi i atij në minierë atje, n'horizontin e shtatë a tetë ku e ka jetën n'rrezik dhe nxerrë xehe për t'mirën e popullit, për t'mirën e vendit, jo të popullit. Unë po flas... se kjo osht' pak gjuhë e vjetër. Për t'mirën e vendit, ai duhet marrë edhe dhetë herë, njëzet herë, tridhetë herë ma shumë se unë. Qikjo osht' puna. Do t'thotë barazi t'plotë n' mes njerëzve kurrë s'ka me pasë. Edhe për një arsye tjetër të veprimt të ligjit mbi harmoninë në natyrë dhe shoqni, që vepron vazhdimisht. Kaq (buzëqeshë).

Ndodhi mobilizimi i rinisë për formimin e brigadës së shtatë dhe të tetë shqiptare t'Kosovës, mos t'i them shqiptare, t'Kosovës. Por lexohet, dihet. Dhe, në të njëjtën kohë mobilizimi i të rijëve për m'e lshu në luftë për çlirimin e viseve në Mal të Zi dhe në Dalmaci, osht'... kjo ka t'boj me vrasjen në Tivar. Keni ni? A po? Jo vrasje, po plojë! Unë po flas tash për gjenin e popullit, e ndin lëkura se diçka nuk osht' n'rregull me këtë mobilizim. Pse t'shkojnë djemtë tanë me çliru' viset tjera, na e kemi çliru' vendin tonë, dhe ne duam ta organizojmë pushtetin ktu me qita njerëz. Ndodhi që një turmë doli n'shesh n'Gjakovë dhe në shejë proteste, Ali Tetrica një prej atyne nxorri thikën dhe e preu veten {bën sikur po pren fytin me dorë}. Mobilizimi u ndal. U ndal n'Gjakovë, dhe prej Gjakove, shkoi dhe vdiq në Tivar, Dervish Vula. Një gjakovar osht' vra atje. Do t'thotë viktimizimi personal i Ali Tetricës që ka qenë në Lëvizjen Antifashiste Nacional Çlirimtare boni vetëvrasje, u ndal.

Filloi u bo demonstrata e grave të Gjakovës kundër shkumjes së bijëve tanë në Vojvodinë. Ka qenë demonstrata e parë n' Jugosllavi. Gjithmonë n'Gjakovë janë nisë disa gjana. Për fat t'keq, tash nuk na kanë dashtë serbët, nuk po na donë as shqiptarët. Po m'vjen keq! Osht' vështirë me hy n'punë në institucionet e Kosovës si dihet që je i Gjakovës, nuk bon. Kjo o' përshtypja ime e gabushme, ndoshta. Po vështirë osht'. Dhe Gjakova ka mbetë me shtatë lypës, menxi e lidhin mujin me mujë. Shembull e kom vllaun tim, osht' një prej tredhetë kryesorëve të Shtabit të UÇK-së, dhe prokuror i luftës. Ai jeton n'banesën time në Gjakovë të cilën e kom marrë si meritë e pjesëmarrjes në Lëvizjen Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Nana jeme ka qenë jo e para, po ka qenë në mesin e katër-pesë grave kryesore që i kanë pri demonstratës kundër shkumjes së bijëve tanë në Vojvodinë. N'krye t'saj ka qenë Sabrije Vokshi, heroinë. A keni ni për te?

**Donjeta Berisha:** Na tregoni diçka ma shumë për nanën e juaj.

**Musa Dobruna:** Urdhno?

**Donjeta Berisha:** Na tregoni diçka ma shumë për nanën.

**Musa Dobruna:** Nana ime, ju thashë n'fillim a qenë gru e fortë dhe e gatshme për sakrificë. Ndërsa baba im, ka qenë shpirtmadh. Ka qenë shumë dorëllirë. Si duket, ato nxehtësi valësh i kanë pasë t'përbashkëta.



Për nanën një rast t'viteve t'50-ta, një lypëse shtatzanë hyn në oborrin e shpisë tanë, ulet e lodhun thotë "M'jep pak bukë". Nana shkon e merr tenxheren me pasul me mish edhe bukë, e i jep me veti e shkon. Dhe, vjen baba mas orarit t'punës. Nuk ka pranë me u bo far kryetari i komunës nëpër fshatëra, "Nuk kom shkollë, atje duhen njerëz me shkollë". Ai e ka pasë vetëm shkollën fillore, por jo. Vjen me hangër sillë, "Çka ka për sillë?" Nana i thotë, "Çka ki pru?" (Qeshë). Se ajo e ka bo gati ato përpara, i ka fshehë por... tash nuk don me e pranë, t'i themi "faj" {bën thonjëzat me duar}, tash nuk osht' faj ai, po... Dhe, ungjet e ha, po i paknaqun me çka ka gjetë. Nuk e di, nuk e kom s'paku përshtypjen e njerëzve t'pasun që osht' me njëfar butësie me e marrë ato mirë çka ka gjetë (buzëqeshë). Po du me thanë se kanë qenë shpirtmëdhenjë.

Tash një digresion, po kaloj në vitin 1941. U shpall se filloi lufta në Jugosllavi, në lagjen ku ishim na ka qenë një mekanik. Erdh një serb e mori pushkën e qiti dhe dha shejë se prej sot Gjakova gjindet në luftë. Ishte ditë pazari dhe xhandarmëria dhe paramilitarët, dhe në atë kohë ka pasë paramilitarë, vritshin njerëz rrugëve. Ne nuk e kemi mbyllë derën e shpisë, se kur turma ka marrë me ikë, një derë mbyllë, një derë mbyllë, dera jonë ka qenë e hapun. E kemi pasë mundësinë se kemi pasë edhe një derë tjetër që dilej në një oborr t'madh t'gjanë, kшту që shpëtojshin njerëz. Dhe, një dalje tjetër në anën tjetër të rrugës ku kanë mujtë me ikë. Mirëpo, për fatin tonë nuk hyjshin xhandarmëria. E gjejshin derën mshelë, e lijsin ashtu.

Po ju thojshin "dobrovoljac", vullnetarë, ashtu *dobrovoljac* i thojshin. Mirëpo për fatin tonë, erdhën dy gjermanë në motor dhe mo u ndalë ajo. Filloi plaçkitja e kasanave, qysh ndodhë mas çdo lufte, ose...

Për herë t'parë në shpi na kemi pasë t'i themi pesë qind kille misër, kallamoq qysh t'dush m'i thanë, prej kasanës që ka marrë baba. Edhe ka qenë hera e parë që ato, ushqimin e ka pasë në kali... me kerr, ka ulë në kallamoq. T'nejtin kallamoq e kemi çu' e kemi blu' edhe për veti. Kemi kalu' qat kohë, ditë shumë të vështira, por kjo madhësia e popullit tonë osht', nuk jonë vra kolonë. Serbë e malazezë që kanë ardhë prej viseve tjera gjatë Jugosllavisë Mretënore i kanë marrë tokat e qytetarëve, t'vendasve. Dhe në qato kohë erdh një i anës t'kufinit, një malazet dhe iu lutë babës, "Ju si familje e madhe, dhe e fisit Gash, na prini dhe ata nuk na ngucin neve". Dhe qashtu ndodhë, kolona prej dhetëra kerreve me kafshë që ishin, kalojshin shpërbllim pare nuk kishin, babës ia jepshin ka një pushkë, secila familje. Pushkët i futshin nër... ashtu rraqe çka kanë pasë. Dhe kur kalonin pranë rojeve gjermane, baba iu dorëzojke një pushkë ose dy atyne, ata babës ia rrihsin krijët, pushkët tjera i kishim na aty. Vazhdojshim rrugën, i çojshim deri në Deçan. Kolonët malazezë që kanë ardhë prej Malit t'Zi në tokat tona. Qato pushkë pastaj i kemi shitë edhe e kemi punu' tokën, molla e duhan.

Qat duhon ma vonë e përpunonim dhe e shitshim. Mirëpo pat qenë interesant se patëm marrë dy vajza që i bojshin paqeta, dhe qashtu t'paketume, kah tre qind deri në pesë qind kilogram duhon i kemi çu për në Sijenicë. A e din ku o' Sijenica? Në Sanxhak. Novi Pazar, Sanxhak. Mirëpo, kah malet e Rugovës, nëpër Pejë, e atje. Kanë kalu' nëpër zonën ku e kanë pasë çetnikët. Osht' dashtë një pjesë me ju falë atyne duhon, se duhonin e pijshin krejt. Mandej, vijshin ma tutje partizanët edhe atyne edhe kanë mrrin deri në Sijenica ku ka qenë një aktivist i Lëvizjes Nacional Çlirimtare musliman përndryshe, Deda. Vetëm këtë emër e di, s'ja di mbiemrin. Kthehej për andej, jo me pare, po me dhenë, kuaj, bylmet, djath e kajmak si... ndërri i mallrave. Dhe, dhentë u duhke me i rujtë, na qytet s'kemi pasë po ndodhi që 25 krenë dhenë u deshtë me i qitë në fushën e tyrbes përtej Erenikut në Gjakovë me i kullotë.

Dy ditë ma vonë po vjen Ismet Mula. A e din kush osht' Ismet Mula? Jo. Dikur ka qenë drejtor i shtëpisë botuse "Rilindja". Djali i tij e ka pasë një dyqan fotografish qaty te Dora, poshtë e ka pasë një atelie, qitu banon diku. Ismet Mula e sjell një letër, të mbyllun kuptohet. Unë isha me vllaun dhe thotë, "Kto duhet me ia dërgu' Fadil Hoxhës. Por në dimën keni me marrë prej njësitit t'parë që mund ta takoni gjatë shkumjes në fshatin Devë." Me mu erdhi edhe Asim Bluta.

Asim Bluta ka qenë një prej aktivistëve të Lëvizjes Nacional Çlirimtare dhe e shoqnovë deri në fshatin Devë. Letrën e mbajshë unë. Atje arritëm sa ra muzgu, trokitëm në derën e parë të një kulle, aty na doli roja partizane se paska qenë Shtabi aty. Na la të presim, shkoi e lajmroi komandantin, ai zbriti shkallëve, erdh na morri, na çoi në katin e epërm. U ulëm dhe për verifikim na luti ta knonim një kangë partizane.

Për verifikim, “A dini kangë partizane?”. E knum kangën për Hysni Zajmin që sapo ishte vra në Plavë, s’bashku me t’zotin e shpisë ku osht’ strehu’ Hajro Shamanoviçin. Atyne ju pëlqei kanga dhe na morrëm me u çu. Komandanti na tha, “Mund të udhëtoni mas darke në përcjelljen e partizanëve”. E hongrëm darkën dhe u nisëm natën nëpër hanë. Mrrimë në Babaj t’Bokës prej Devës, na drejtun në Shtab. Atje kishte qenë Shtabi i Brigadës së Pestë shqiptare, komandant Shëfqet Peqi. Ai e morri letrën, e ndezi shkrepën e lexoi vetëm titullin e tha... e mbylli, “Nuk osht’ për mu. Fadili gjindet në operacionet në luftë kundër kolonës gjermane që tërhiqej prej Greqisë”. Vetëm kaq dhe ai shkoi në punë t’vet. Na shkumë e gjetëm një kasolle, u shtrimë qashtu t’lodhun edhe na zbardi drita edhe dolëm në sheshin e fshatit, loma i thojnë aty ku bohej gati gruni, e hedhshin në atë kohë.

Dhe pamë një epror tu iu folë partizanëve për gjendjen aktuale t’asaj kohe. Kur shkova aty e pashë një shok temin Skender Hoxha e ka pasë emrin dhe dy serbë, njërin prej të cilëve deri vonë e kom shoqnu’ herë pas here. Ka ditë shqip si une. Dhe një serb tjetër, i cili ma vonë ka bo krime në Gjakovë. Dhe prej atyhit ndërkohë ka ardhë Asim Bluta, dhe ka thonë, m’tha se erdhi Fadili edhe po shkojmë po takohem me Fadilin. Kemi shku’ në kullën e gjyshit të Jusuf Bajraktarit. Jusuf Bajraktari tash osht’ akademik, anëtar i Akademisë t’Shkencave për çashtje t’historisë. Ka qenë drejtor i Entit të Historisë deri vonë. Aty ka qenë takimi im i parë me Fadil Hoxhën, dhe në kullë kom ndigju bisedën e t’mëdhenjëve t’rritunve. I zoti i shtëpisë ndigjonte, dhe ka përcjellë me kujdes t’pranishmit, në mesin e të cilëve ishin dy partizanë me plisa t’rrafshët të dibranëve, me herkë dhe tirqë t’zi. Por nuk flitshin asnjë fjalë. Erdhi silla, u ulëm, silla e begatë, u ulëm, hangrëm. U kry ajo, arritën kafet e elbit në atë kohë me elb i pijshim.

I zoti i shpisë e morri kafen e po i thotë Fadil Hoxhës, “Fadil, po e shoh që nuk qenke vetëm. Ktyne nuk ju zihet besë”. Ishin ata dy partizanët të Brigadës maqedone që e kanë majtë kontaktin me brigadat, me njësitë tona partizane. Fadili iu përgjegji, “Si me ty sot, e kom pasë një rast në Ferizaj”.

## Pjesa e Tretë

Përqaftimi i Lëvizjes Antifashiste... i turmave po flas për Gjakovën, jo për një vend tjetër, se nuk e di. Ka qenë aq i madh sa dihet, fashistët Gjakovën e kanë qujtë Moska e Vogël. Italianët i thojshin “Piccola Moskva”. Tash do ta ilustrim edhe me diçka tjetër të viteve t’60-ta. Pllenumi i Katërt i Lidhjes t’Komunistëve të Jugosllavisë. Po e vazhdoj kto, masanej...

Emin Duraku me shokë, Hajdar Dushi, Xheladin Hana, Alush Gashi, Xhevdet Hamza, Enver Pula, Xhavit Nimani me vllazën e motra, e shumë të tjerë nëpër Kosovë, e kanë përqaftu’ si luftë shumë të drejtë për çlirimin kombëtar dhe social. Që masnej me ndrrimin e raporteve, murr kahje paksa anti-popullore. Kto anti-popullore lexoni anti-shqiptare. Se, ishte koha e një frymëmarrjeje tjetër.

U hapën shkollat, deri te universitetet edhe Akademia e Shkencave që ishte pengesë e shovenistëve serbë. Që bijke ndesh me ideologjinë e kishës ortodokse serbe e cila sot udhëheqë politikën shtetnore serbe, edhe sot. Kryetari i shtetit serb duhet të betohet në librin e shenjtë ortodoks {zgjatë dorën sikur të jetë mbi libër}, pro-sllav, qysh t’dush m’i thonë. Osht’ punë e tynë! Puna jonë osht’ t’punojmë për vetveten, jo kundër tjerëve. Megjithatë kjo si e tillë, na ka kushtu’ dhe na ka rrudhë aq sa jemi. Për shkak të njëfar tolerance pak të teprume.

**Musa Dobruna:** Me ia nisë për msusët?



**Jeta Rexha:** Po.

**Musa Dobruna:** Mas fillimit të luftës në Jugosllavinë e atëhershme që ishte fillimi i Luftës së Dytë Botnore për ne, grupe qytetarësh që për çfarëdo arsye i kanë tkundë Shipninë gjatë periudhës së Jugosllavisë Mbretënore ktheheshin. Një pjesë e tyre n'krye me Emin Durakum, Fadil Hoxhën, Hysni Zajmin, Xheraldin Hanën, Hajdar Dushin, dhe një plejadë musish të tjerë, Zeki Shehu për shembull daja i Pajazit Nushit erdhën dhe e fillun hapjen e shkollave shqipe. Kjo ndodhi diku në maj të '41, ishte periudha maj '41. E maj n'mend që n'shköllë jom regjistru' si dhetë vjeçar n'klasën e parë fillore. Dhe më ka regjistru' Jusuf Puka. Osh' interesant me e përmen Jusuf Pukën për shkak se ka qenë edhe msus i babës tim (qeshë). Dhe vjen, e ban regjistrimin na ndajnë klasët, germat e para, shkronjat e para siç doni me ju thonë, m'i mson Haki Taha të cilin e kanë vra pastaj Shërbimi Sekret i Serbisë, atëhere i Jugosllavisë. Dhe e kanë lonë kinse ai e ka vra Milladin Popoviçin, çka nuk ka qenë e vërtetë. Dhe, masnej ndërrohen msust sipas nevojës që ka qenë dhe vjen puna deri te Zeki Shehu m'mson, ai vdes shpejt. Dhe na ndrroheshin msust shumë shpejt. Prej të gjithëve kemi msu' se Lëvizja Antifashiste Nacional Çlirimtare osht' lëvizje për çlirimin nacional dhe social t'popullit, pa përjashtim... pa përcaktime fetare dhe nacionale.

Fati historik ka deshtë që ne t'i bashkohemi anti-hitleriane, anti-fashiste, anti-naziste qysh t'doni me i thanë, dhe kjo i përket rreshtimit të Lëvizjes Antifashiste Nacional- Çlirimtare në krahun e aleatëve të mëdhej Shteteve të Bashkume të Amerikës, Anglisë, Francës dhe Kinës n'atë kohë, Bashkimit Sovjetik kuptohet. Bashkë me ne, atktivitetin anti-fashist e kanë zhvillu' edhe serbët edhe malazezët edhe të tjerë. Komunistët kanë pasë vizion dhe e kanë shfrytëzu' një moment kritik n'Gjakovë me ardhjen e italianëve u hapën gjashtë-shtatë bordele - m'falni që po shprehem kshtu - dhe e shfrytëzun mosknaqësinë e popullit ndaj ktyne akteve. Dhe, na u bashkunë të gjitha forcat anti-fashiste, n'mesin e t'cilëve nuk kishte komunistë. Kishte njerëz që nuk e dojshin komunizmin, nuk e kanë deshtë komunizmin. Pse? Ata e kanë identifiku' me Rusinë, rusi osht'... ia kemi pa sherrin gjithmonë edhe maroj puna aty. Megjithate, populli na u bashku', dhe komunistët si organizatorë t'mirë, dhe propagantorë t'shkëlqyshëm kisha me thonë, e mobilizunë popullin e Gjakovës. E unë kom bindjen se nuk ka pasë qytetarë gjakovarë që kanë luftu' kundër partizanëve, edhe pse e kanë ditë edhe nuk i kanë deshtë partizanët. Akte anti të armatosuna nuk ka pasë.

Tash, unë e kom bindjen e thellë, dikush mund t'thotë se, mund të mos pajtohet, por të gjitha lëvizjet që kanë ekzistu' gjatë Luftës së Dytë Botnore, kanë qenë shqiptarë. Për çashtjen shqiptare kanë luftu' n'mnyrën e vet. Edhe Balli Kombëtar nuk ka pasë ndikim t'madh n'Kosovë. Zogistët, Legaliteti, dhe intelektualët e pavarun qata që i kemi pasë. Edhe shpiunët ma t'mëdhenj siç ka qenë Beqir Maloku për shembull, ai ka qenë komandat i xhandarmërisë, ka ditë si merr frymë Gjakova po nuk ka marrë masa. Osh' bo atentat n'te si komandant se edhe si shpiun shumë i afirmumë me karrierë qysh n'kohën e Turqisë, kanë bo atentat n'te Fadil Hoxha me shokë. Por, vetëm osht' plagosë. Ai ka ditë se si merr frymë Gjakova. Gjakova ka qenë krejt n'lëvizje (qeshë), dhe italianët e qujshin "Piccola Moskva" – Moskë e Vogël.

Kisha me bo një digresion, mas Luftës së Dytë Botnore. Në vitet '60-ta kur mbahej Pllenumi i Katërt i Lidhjes së Komunistëve të Jugosllavisë, ku u demasku' Shërbimi Sekret Jugosllav, sidomos ai serb. Dhe e pys një operativist si i thojshin atëhere që osht' gjallë hala, n'tavolinë ishin katër, dy u çunë, ai nuk e ka pi duhanin, po nuk ia ndante cigare mas cigares, i thomë, "Mirë Nuhi, çka osht'? Kur ia nise duhoni?" Tha, "Çka osht' politika?" Masi e kom kry stazhin në punë në Sekretariatit e Punëve t'Mrendshme, t'u shërby nëpër të gjitha qendrat e Kosovës, jom pensionu' dhe ka marrë vesh Dushan Mugosha atëhere sekretar politik, udhëheqës kryesor i Krahinës Autonome n'atë kohë dhe thotë m'u kthy n'shërbim dhe, "Ki me shku' me shërby në Gjakovë". Dhe, notat që i jep ai tash, por thotë, "Kom punu' me sukses në të gjitha qendrat, por ma vështirë se me punu' n'Gjakovë nuk ka". "Pse?" "Për shkak se nuk dijmë kurrëniher se me kon kem punë". Osh'... s'e di, osht' popullatë interesante. Jonë shumë pragmatistë, por në pafuqinë e

tyne tash kanë metë {ulë duart kah dysHEMEJA} shtaga e lypës. Aktualisht, shtagën e lypës ia kanë dhonë Gjakovës edhe pse kanë rreth tre mijë në UÇK, n'mesin e tyne unë kom... jemi njimdhjetë na që kemi marrë pjesë, fmitë e motrës edhe të vllazënve. Qët digresion e bona për m'e pa se çka osht' Gjakova. Gjakova sot osht' e nëpërkambur. Kjo o' bindja ime e palëkundur. Gjakova që ka pasë 27 mijë punëtorë, sot mezi e lidhin mujin me mujë. Për mu, prijësit e UÇK-së Gjakovën e kanë tradhëtu'. Le t'hojnë çka t'dojnë ata.

Murrëm dy havanxhi që e grijshin duhanin, ashtu bohej (buzëqeshë), n'mnyrë... Dhe, kemi pasë dy vajza që bojshin paketë. Atë duhan t'paketum, zakonisht kah pesë qind kilogram i ngarkonte baba e i çonte në Raushic afër Pejës dhe prej andej me karavan me kuaj t'ngarkum i çonte në Sijenice. Kalonte nëpër viset që i kanë pasë çetnikët, praktikisht i ka korruptu' t'u i dhonë duhan, e duhoni n'atë kohë nuk gjiindej. Kalonte në zonën e partizanëve, edhe aty u deshtë me iu dhonë duhan dhe mrrinte me aq sa i ka tepru' duhan në Sijenice te udhëheqësi mbiemnin e t'cilit nuk ia di, por Dedë e ka pas emnin. Atë duhan e këmbente me dhenë, mish t'terun, bylmet, kuaj, qylyma e tjera sene, po pare jo. Kur erdh n'Gjakovë, pa u bo dy ditë, unë me vllaun i kullosnim delet, dhentë. Erdh baba im me Ismet Mulën dhe Asim Bluton dhe ata aktivistë t'Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Letrën e morra... Ismet Mula dhe baba u kthynë, Asim Bluta erdh me mu. Rrugës për në Devë, takojmë një njeri e kishte pasë shoqën përmas n'kali. Na pytë, "Ku po shkoni?" Asimi u përgjigj se po shkojmë te filani... një neri që na pyti e njifke. Dhe po vazhdojmë rrugën, ai shkoi n'punë t'vet. Mrrijmë në Devë masi ra muzgu. Në kullën e parë që pamë dritë trokitëm n'derë, dul një partizan. Ia dhamë letrën, thotë "Kte ia tregoni komandantit". Komandanti zbreti shkallëve, e morri letrën, e lexoi, tha, "Nuk osht' për mu" E mbylli, thotë "Ejani nalt". U ulëm, ai, dy partizane edhe një partizan ishin rreth nesh. Na verifikun s'pari se kush ishim, dhe për me ia mbyllë krytë asaj na vetën a dijmë kangë partizane. E knum pa... menjihere, kangë për Hysni Zajmin dhe Shahmanoviçin, Hajro Shahmanoviçin që jonë vra tradhëtisht në Plavë. E knumë kangën, ju pëlqei shumë dhe murrëm m'u çu. Komandanti tha "Jo, do t'hani darkë e pastaj do t'ju jap përcjelljen dhe do t'shkoni në Babaj t'Bokës."

Komandant ishte Elez Isufi, msus i vllaut tim. Elez Isufi ishte bir i Isuf Elezit që ka marrë pjesë bashkë me Ismail Qemalin në Shpalljen e Shipnisë të pamvarun. U çumë morrëm rrugë për Babaj t'Bokës, natën nëpër hanë, ishte vjeshtë e bukur. Mrrijmë n'Babaj t'Bokës dhe iu drejtumë komandantit t'Brigadës Pesë, Shefqet Peqi. Ai dul, si ndodhi me Elez Isufin, e ndezi shkrepën {bën sikur po lexon letrën}, "S'osht' për mu. Shoku Fadil gjindet në operacionet kundër kolonave gjermane që po tërhiqen prej Greqisë. Nesër kthehen," dhe shkumë me pushu'. Hyjmë në një kasolle atje, tokë. E bomë një pushim (qeshë), pushim i thoshim. Të nesërmen u çumë paksa heret dhe dolëm n'sheshin e fshatit, n'loma i thojshin ata ku bohej hedhja e grunit, n'mnyrën tonë kshtu, dhe pamë një grup partizanësh. Komandanti n'komë i qortonte se "Ne kemi marrë pushkën me luftu' kundër fashizmit por sa ma pak m'u damtu'. Nuk osht' mirë që t'luftoni n'kamë, toskët luftojshin n'kamë" (qeshë), qashtu ka qenë atëhere... toska i vogël.

N'qato fjalë erdh komandant Shefqet Peqi edhe tha, "Gjindemi në pragun e shlirimit definitiv të atdheut t'Shiprisë, por operacionet tona do të vazhdojnë edhe në tokat jugosllave deri në dëbimin e plotë të forcave naziste nga vendi. Ky është urdhëri i gjeneral kolonel Enver Hoxhës, komandantit tonë gjeneral kolonel Enver Hoxhës." Me kte e përfundoi, ne u çumë, erdh Asimi, "Po shkojmë se erdh Fadili" n'kullën e gjyshit të Jusuf Bajraktarit, akademik, ka qenë drejtor i Institutit të Historisë. Hyjmë në dhomën e pritjes t'burrave si i thojshin atëhere (qeshë), qysh i thojnë edhe sot. Më priti Hysen Zherka, Ceni që i thojshim se ka qenë shok i imi. M'prezntoi para Fadil Hoxhës dhe ai vazhdoi muhabetin me... t'pranishmit aty. Në mesin e t'pranishmëve ishin edhe dy partizanë të Brigadës maqedone, po t'veshun me tesha shqiptare me plisa t'rrafshët dibranë, edhe herkë edhe tirqë t'zi. I zoti i shpisë gjatë gjithë kohës ka heshtë. Erdh koha e sillës e shtrumë bukën. Nji sofër t'pasun qysh dijnë shqiptarët kur dojnë me pritë mysafirët e nderumë. U kry sillja, erdhën kafet e elbit (qeshë) sikur tash që po i reklamojnë edhe t'u pi kafe, i zoti i

shpisë e morri fjalën edhe iu dretu' Fadil Hoxhës, "Fadil" i tha "djali jem, po e shoh që nuk qenke vetëm. Ktyne nuk iu zihet besë".

Kjo ka qenë refren n'kohën e luftës botnore n'Gjakovë, du me besu' se edhe n'Kosovë, se me serbë edhe malazezë nuk ka besë. Na e dojmë dhe e përkrahim Lëvizjen, por sa herë që iu bjen n'men lufta e përbashkët me serbë e malazezë, njerëzit kanë rezervë. Kjo ka qenë bindje manej e krejt Shtabit të Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare, komunistëve shqiptarë po flas, për komunistë. Shqiptarë t'Kosovës të cilët kanë marrë vazhdimisht qësi informatash se populli osht' me Lëvizjen Nacional Çlirimtare, por Vllaznim Bashkimi s'iu pëlqente për shkak të vujtjeve shumë të mëdha që ka pësuar populli shqiptar në Jugosllavi natë kohë, në Jugosllavinë Mretënore.

Mas sillës dhe kafet që i pimë morrëm rrugë për në Krunë ku ka qenë Shtabi operativ për Kosovë në Rrafshin e Dukagjinit. Shtabi ishte vendosur në internatin n'Kosovë ku kanë, i kanë kry shkollat djemtë që për çfarëdo arsye kanë ikë nga Jugosllavia në Shipni. Në rrugë për Krunë, iu afrunë Devës. Në një moment njëfar Musa Efendia ka qenë luftëtar i Lëvizjes Nacional Çlirimtare ashtu... i tha Fadil Hoxhës, "A t'hijmë të Begu ta pijmë ka ni kafe?" Aty ka pasë Shtabin Gani Begu. Gani Begu Kryeziu i cili e ka pasë Akademinë Ushtarake t'kohës t'Jugosllavisë t'kryme, ka qenë doktor epror ushtarak. Por, s'i ka pasë njësitë e veta, edhe ai ka luftu' kundër fashizmit. Bashkëpunimi me komunistët ka qenë i ngushtë për aq sa ai ka pasë besim. Në propozimin e Musait, Fadili tha "Jo!" "Pse?" "Osht' idhnu' me mu. Ma ka çu një letër 'Pse po m'i merr partizanët?'" Ai në shpinë t'letrës, t'nejtës letër i shkrun "Unë nuk kam stërlinga me iu dhonë". Do t'thotë Begu ka qenë njeri i blemë, ka punu' me ndihmën kundër fashizmit me ndihmën e Aleatit t'Britanisë t'Madhe n'atë kohë që i ka çu funta stërlinga ari për m'u financu' Lëvizja.

Dy kanta t'metalta qasi i kemi pasë n'shpi tonë. Ndodhi që nana ime e hapë po pa e pytë babën. Edhe n'moment vjen baba, "Çka po bon?" "Po e marr veç një stërlingë," ari ato "me ia bo djalit kur t'bohët për martesë". Baba ia murrë e la aty, e mbylli dhe ia dorëzon Gani Begut.

E lamë Devën dhe mbrimë në Qafë të Prushit ku ka qenë kufini, ku edhe sot ekziston kufini me... atdheun (qeshë). Qishti i thonte Teki Dervishi, "Kufini me atdheun". Aty iu tremb kali Fadil Hoxhës se i doli gjarpëri, nëpërka që ka plot atje në shtigjet shkambore në kufi. Shkoi Musa Efendia e shkeli, vazhdumë rrugën dhe u nalëm në Golaj. Në Golaj Fadili e thirri Ibrahim Zherkën, ka vdekë i ri ka qenë historian i cili e ka deshtë Fadilin si birin e vet. Thirri po s'u përgjigjë kërrkush dhe vazhdum rrugën. Për m'e bo ma t'lehtë rrugën Musa Efendia pyti prapë, "Ani Fadil, kom marrë letër edhe prej Dem Ali Pozharit." "Ani?". "Ma ka çu ni letër, thotë 'A ma falë jetën se po bohna me ty, me kô kom?'" Fadili i përgjigjet n'letër, "Jo. Nëse na bjen rasti m'u taku' na n'fund kem m'u kqyrë nëpër thumb t'pushkës". Kte për shkak se Dem Ali Pozhari ka luftu' me armë kundër partizanëve. Por, Fadili nuk e ka ditë një detaj. Aty ku ka vu pritë Dem Ali Pozhari me t'vetë, dhe ka konstatu' se n'mesin e partizanëve nuk ka serbë e malazezë, osht' tërhekë, nuk ka luftu'. Po aty ku ka pasë serbë e malazezë kurrë pushkën s'iu ka ndalë.

Dem Ali Pozhari mas Luftës t'Dytë Botnore, n'vigjilien e mbarimit t'Luftës t'Dytë Botnore ia therrë shkon n'Greqi e manej n'Turqi edhe vdes në migrim. Dhe prapë edhe një pyetje tjetër tash me e shkurtu' rrugën, Musa Efendiu i thotë Fadilit, "Ani a ke [e pakuptim] diçka tjetër?" "Kom marrë letër prej Ejup Binakut". Ejup Binaku ka qenë sekretar i Partisë Fashiste n'Gjakovë, edhe n'shpinë t'letrës ia kthen thotë, "Eja kur t'dush". Tash vjen pytja logjike e Musait, tha, "Ne jemi n'luftë me fashizmin, nazizmin. Ti i refuzove dy, pranon me ardhë n'hallall Ejup Binakun si sekretar t'Partisë Fashiste". Ktu ndryshojnë punët. Ejup Binaku osht' person i cili n'mes t'dy Luftërave Botnore ka ndihmu' sa ka mujtë t'rijtë që për çfarëdo arsye jonë largu' prej Jugosllavisë e kanë kalu' në Shipni. Osht' angazhu' në shkollimin e tyre, punësimin dhe strehimin. Atij i kom borxh, dhe Ejup Binaku vjen n'hallall.

Mrrijmë në Krunë dhe mu m'caktojnë me fjetë në dhomë me Hilmi Aganin, profesor, ma vonë profesor Hilmi Agani që ka qenë. Ai mas disa javëve... masi osht' siguru' se unë jam besnik, po m'thotë një natë, "Kom me t'thonë diçka, por n'qoftëse ma jep besën se nuk flet, nuk i tregon kërkujna". Thash "Po". "Nji rast t'rrethumë prej forcave t'Muharrem Bajraktarit, na osht' deshtë që dy netë e tri ditë t'fshihemi nëpër shkurrë në Has të Gjakovës, për shkak se ai ka qenë në forca t'mëdha na ka rrethu'. Na jemi fshehë dy netë e një ditë," tha "edhe etjen e ujin e kemi shu tu marrë pemë t'ëgra. Dhe kemi marrë lajm se forcat e Muharrem Bajraktarit janë tërheqë. Na jemi kthi për në Krunë, rrugës për në Krunë në fshatin Cahan, Pavle Joviçević që ka qenë udhëheqës i Partisë në Shtabin Operativ për Kosovën n'Rrafshin e Dukagjinit, i jep letër me çu në Kishaj një fshat gjithashtu n'Shipni osht', me pritë me marrë përgjigje dhe me u kthi, me ia kthi përgjigjen, edhe pse e dinte se jom i dërrmum, i lodhun, i untë. E morra detyrën, shkova e kreu dhe n'kthim u nala në një shtrojerë me pushu. Nuk ka zgjatë shumë dhe po i nij hapat e diku që po afrohet me përcjellsët, truprojet e tyne. Shkova ia dhashë raportin, u ktheva n'vend temin. Ata nxorrën pite e mish, po hanë. Mu nuk m'thirrën edhe pse e kanë ditë që jom i dërrmum edhe unë, "Çka osht' kjo?" "Veç t'a dish" (qeshë), vetëm kaq. Për mu ky ka qenë indoktrinimi i parë se bashkëpunimi me serbë e malazezë osht' shumë i vështirë.

Dhe ndodhi masnej tërheqja prej Krune për me iu afru' Gjakovës, kalumë në Tropojë. Në Tropojë u vendosëm, mu m'caktunë me fjetë në depo të pëlhurave dhe t'rrobave të ndryshme, bashkë me një serb t'Gjakovës dhe një shkodran. Masi u vendosëm, dulëm, ramë poshtë për me marrë darkën. Une e kom pasë një gavatë, gavatë që vëhet ktu {tregon brezin}, për ushqim e për me pi e me hongër. E nxjerr ato e përgjegja serbisht, "Nisi na evidencija" [Ju nuk jeni i regjistruar] – "Nuk je në evidencë në kompaninë e parë, po je në t'dytën". Unë si i ndigjushëm, shkoj në t'dytën, e shtrij dorën, prapë, "Nisi na evidencija". Dhe i idhnumë, por pa protestu', kthehem n'dhomë dhe e gjej aty bacën Bajram atë far burri shkodran, ai e vërejti që diçka s'o n'rregull me mu edhe m'tha "Çka ke mor?" Thashë "Kurgjo!" Tha, "Jo, jo ti një dreq e ke" (qeshë). Dhe i tregova ngjarjen. "Çohu!" tha. M'murrë për dore, sa i kisha unë, pa i mushë 14 vjet. Shkoj n'kuzhinë, "Nxirre gavatën", ia çes, tak {bën sikur po mbushë gavatën}, ma jepi ushqimin. Edhe kjo zgjati me javë. Herë m'përcillte, m'shoqënonte Safete Nimani, herë Dragi Kirljeović, herë Xhafer Vokshi – anëtar i Shtabit.

## Pjesa e Katërt

Nëntor 1944 që merr flakë spitali partizan dhe angazhohemi t'gjithë me kofa me çka kem pasë. Unë bashkë me një gjerman që ka qenë antifashist, dezertër i ushtrisë gjermane, ka qenë piktor i mirë, gjithë natën kemi shkrujtë. Në mëngjes, takoj një gjakovar, njëfar Minush Xërxa edhe i thom, "Ku po shkon?" Tha, "Po kthehem n'Brigadë. A po m'pritni pak?" "Po". Shkoj une me marrë bukë, nuk m'jepin prapë. Prej atyhit shkoj në Shtab, i paraqitem Xhafer Vokshit të ndjerë edhe i thomë, "Une shkova n'Brigadë". N'qat moment po zbres shkallëve, edhe Pavle Joviçević.

Ai zbriti shkallët dhe me një pallto të ushtrisë angleze t'gjatë kshtu dhe hijerandë. M'mati pak edhe tha "Jo. Ne možeš!" [Nuk mundesh!], se Xhaferi i tha ky po don me shku' në Brigadë. Ai m'mati edhe tha "Jo!". Unë fjalën e fundit ia dhashë Xhaferit, thashë "Shkova". Kjo ishte data 8 nëntor, 1944. Mrrijmë bashkë me Musa Batallin e kom pasë shok klase, dhe një dy partizanë tjerë. Mrrijmë n'Bobaj t'Bokës dhe diku pak pa ra muzgu vjen baba im me njëfar Sami Morinën na lajmrojnë se forca okupatore n'Gjakovë mo nuk ka, edhe se kazermat osht tu i ru Ethem Stublla. Profesor Ethem Stublla me akademi ushtarake t'kryme n'Romë, dikur komandant i guarnizonit t'Palermos dy vjet. Dhe nisemi, bohet riorganizmi i Brigadës Katër mas operacioneve që i ka pasë dhe nisemi për në Gjakovë, n'komë. Ra bora e parë, kur kemi mrri te Ura e Tabakut... a keni qenë n'Gjakovë noj here? Osht' ku janë vorrezat, aty janë dy ura. Jusuf Zherka na ka mobilizu' na thirri, kemi hy n'Gjakovë t'u knu' "Bashkohemi shokë ne në çeta", kongë e tjerë e tjerë.

Shtabi Operativ për Kosovë dhe në Rrafsh Dukagjin, mas riorganizimit të Brigadës Katër kosovare, e cakton kompaninë e Jahja Osmanit që ka pasë nofkën “Zhivko” me hy e para n’Gjakovë. Përbamja e asaj kompanije ka qenë gati gjysë për gjysë serbë e malazezë edhe shqiptarë. Kjo osht’ djallëzia e serbëve n’atë kohë që me thonë se vendin e kanë çliru’ serbët. Po kjo nuk ka ndodhë, jonë munu’ n’Gjakovë me bo ksi senesh. N’Gjakovë nuk kanë mujtë me i kry krejt detyrat që kanë pasë simas projekteve t’tyne, eliminimin e shqiptarëve e ktyne tokave.

Menihere ka vepru’ Shërbimi Sekret Jugosllav, t’i thom serb me fjalë tjera. Edhe ndodhë që krejt shtabin e Gani Begut e marrin, i burgosin dhe i vrasin të gjithë Kryezestë që kanë qenë, që kanë mujtë me i zanë n’atë kohë, dhe i vrasin n’mënyrë shumë barbare. Gani Begut e çojnë në burg në Srpska Mitrovica - në Mitrovicë atje ka qenë burgu famëkeq - dhe atje përfundon jeta e atij. Përkundër kërkesës së qeverisë britanike që ai të mos likuidohet për shkak se ka qenë njeri i tyne, bashkëpunëtor me anglezët, do t’thotë, ka qenë antifashist i djathtë, jo si Fadil Hoxha me shokë, me Emin Durakun, me Hysni Zajmin, me tjerë që kanë qenë t’majtë, n’anën e majtë... për shkak se ne kemi pasë përfitime shumë të mëdha prej asaj Lëvizjeje.

Cilat kanë qenë përfitimet mas Luftës së Dytë Botnore të shqiptarëve t’Kosovës dhe përgjithësisht në Jugosllavi, por konkretisht n’Kosovë? Hapja e shkollave n’gjuhën shqipe, administrata që me mundime t’mëdha, me përpjekje shumë t’mëdha osht mbërri me u bo administratë në gjuhën shqipe. Fillojnë shkollat, hapet Shkolla Normale shqipe në Gjakovë. Unë e kryj klasën e parë edhe t’dytë për një vit me program t’shkurtuar për shkak se ka qenë nevoja shumë e madhe për msusë. E kryj edhe klasën e tretë edhe n’korrik t’vitit 1950 na çojnë në kursin pedagogjik, kursin e naltë pedagogjik në Pejë. Ditën kur e marr maturën, ma dorëzon Zeqeria Rexha i madh, i madh për shkak se gjithë jetën, gjithë aktivitetin e tij mas luftës e ka derdhë për arsimimin e popullit. Dhe tha kështu, “Me pasë thonë dikush n’vitin 1939 se n’Kosovë n’vtin 1941 do ta kemi administratën n’gjuhën shqipe dhe shkollat n’gjuhën shqipe, atë njeri do ta kishin shpallë se ka fillu’ me luftë pak. Po ja që e bomë na. Por me pa konë dikush n’vitin 1941 se n’vitin 1950 na do t’i qesim tre qind msusë përiherë, atij njeri do t’ja kishin veshë kmishën e t’çmendurit. Po ja që e bomë! Dhe ne do t’i bojmë edhe të tjerat”. Dhe ato tjerat u bonë me sakrifica shumë të mëdha, prej shkollave fillore e deri te Akademia e Shkencave. Dhe u ndërtunë shkollat, spitalet gjatë qasaj kohe.

Do t’thotë, unë mendoj dhe kom bindjen e thellë, se rezistenca kundër t’i themi asaj kohe atij regjimi, osht’ bo në dy mënyrë. Në mënyrë institucionale t’u e kundërshtu’ shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi e venet tjera simbas marrëveshjes e vitit 1937, n’mes të Jugosllavisë Mretënore edhe Turqisë për shpërnguljen e turqve prej ktuhit, se shqiptarët muslimanë i kanë qujtë turq. Rezistenca ka qenë e qasaj super-strukture politike të komunistëve shqiptarë t’Kosovës. I janë kundërvu’ dhe dami ka qenë shumë ma i vogël se mos t’kishin qenë komunistët. Kto po e thom jo për me i mshelë gojën sharllatanëve që flasin kundër Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare për çlirimin nacional dhe social. Por, me ju tregu’ se nuk keni të drejtë që në mënyrë t’vrazhdë të sulmohet një Lëvizje shumë humane - Lëvizja Antifashiste Nacional Çlirimtare.

Ndodhë në dhjetor të vitit 1943 që n’shipi tonë të vijë Ismet Shaqiri. Ishte në fund të nëntorit dhe ai e pyti babën dhe nanën time, nana ime ka qenë agjitor për Lëvizjen Nacional Çlirimtare dhe dinte mirë me thurrë kangë vaji kur vritej ndonji partizan ose noj aktivist. Nanën e pyti, “Si osht’ gjendja, situata aty?” “Populli,” thotë “osht’ krejt me ne, por” - po kthehem e thash edhe pak ma përpara - “kur përmendet Vllaznim-Bashkimi, bashkëpunimi me serbë e malazezë ka rezerva t’mëdha”. Ai u përqesh, “Ne nuk mund t’iu themi popullit se qe nuk po bashkëpunojmë me serbë e malazezë. Po ejani, rrokni armët edhe ejani me ne për shkak se së bashku jemi t’u luftu kundër armikut t’përbashkët – fashizmit. Kësaj të keqe që i ka rrëmby Evropën”.



N'qato fjalë erdhi kushëriri jem Sylejman Dobruna që ishte kthi prej Gjermanisë me u knellë, e ka punu' në minierat e Ruhrit në Gjermani, nxirrej thëngjilli n'atë kohë. U prezentu' me Ismet Shaqirin dhe i tha, "Mirë paske bo, koke kënellë e tash osht' mirë me ardhë me u bo partizan se shpejt kemi me çliru' venin. Kem me organizu' jetën si n'Bashkimin Sovjetik" Ai kushërini jem si i rrëmbyshëm që ka qenë, tha "Kurrë!" "Kurrë?", Tha, "Si n'Bashkimin Sovjetik? Po unë jom kapuçkadër n'minierë". Kapukadra osht' kryepunëtor kështu' n'atë zhargonin e atëhershëm po flas. "Mu punëtorët e atyhit që jonë t'gjithë t'burgosun, të gjithë sllavë – rusë, serbë, malazezë, kroatë, e tjerë, m'dojnë si me qenë baba i tyne". "Qysh t'donë?" "N'momentin kur kom shku' une kom organizu' një formë signali, n'fillim me një kabëll e kom tërhekë kabllin e n'fund n'zgafellë atje ku osht' nxerrë thëngjilli kanë qenë punëtorët për me i lajmru' se po vjen komandanti, bini punës. Kom kriju' rezerva n'hymje të zgafellës, rezerva thëngjilli, i kom mbulu' me gurë me diçka por i shplojshim. Vinte ai por i knaqun me punën e tij ma rrehke krahun, punëtorëve ju shtojke ushqimin që e kanë pasë vetëm bukë edhe kafe, kurgjo tjetër. Dhe, ata thonë deklarohen se mas marimit t'luftës na nuk do t'kthehemi n'Bashkimin Sovjetik, se ma mirë e kemi ktu n'llogor sesa atje." Ismeti gjithashtu i rrëmbyshëm, po t'mos kishte qenë te na, e kishte vra. Ai tha, "Atje jeta n'Bashkimin Sovjetik, unë nuk kom qenë, ata m'kanë thonë që nuk osht' mirë". Ktu përfundon.

Të nesërmen Ismet Shaqiri shkon në Konferencën e Bujanit edhe atje dihet Rezoluta e Bujanit, ju e dini keni ni? Rezoluta e Bujanit po e thom me fjalë t'mija asht që, "Populli shqiptar i Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit dhe përgjithësisht gjithmonë ka andrru' që me i'u bashku' tokës shtetit amë Shipnisë". Qikjo ka qenë ajo. Osht' kanga, hymni i Këshillit Nacional Çlirimtar që une e di përmensh. Nuk di a e di kush n'Kosovë.

**Jeta Rexha:** A muneshe me na thonë?

**Musa Dobruna:** Po. Do t'i lutna dikujt prej kompozitorëve edhe melosin me e thonë, po unë po i thomë vetëm fjalët. {Reciton himnin}

*Me ty o Këshilli Nacional Çlirimtar,  
Ti që na prin dhe na bashkon,  
Me ty sot ngrihet populli shqiptar  
dhe drejt fitores ai po marshon.*

Refreni tash

*Çohi i vllazën pa dallim feje, krahine dhe ideje  
n'luftë t'përbashkët kundër fashizmit.  
Çohuni t'gjithë se koha nuk na pret.  
Çoju të gjithë shqiptarë që don Shqipni!  
Ja sot, ja kurrë, me armë duhet me dalë  
t'përzojmë zaptuesin dhe t'fitojmë lirinë.*

Qikjo osht' ajo. Do t'thotë Lëvizja Antifashiste Nacional Çlirimtare ka qenë për çlirimin nacional dhe social. Por shpejt vjen proklaratat e Shtabit të Jugosllavisë se çashtjën nacionale do ta zgjidhim n'mënyrën ma t'mirë t'mundshme mas marimit t'luftës. N'qat kohë ka ndodhë Konferenca e Jaltës, e Teheranit, e Moskvës n'mes të... ku kanë marrë pjesë Franklin Delano Rusevelt, Vinston Çerçill, Stalini, kta tre e kanë vendosë që kufijtë e Evropës të vendosuna në Konferencën e Paqes n'Paris, në Versajë të mos preken. Kjo osht' përgjigje ma e mirë e propagatorëve që nuk e dijnë historinë, unë po them që nuk e dijnë historinë, ose që jonë tendenciozë gjithsesi tendenciozë se Enver Hoxha e ka shitë Kosovën edhe Fadil Hoxha. Kufijtë e Evropës mos m'u prekë mas Luftës të Dytë Botnore, dhe ka ndodhë qajo që ka ndodhë.

Parëz e përmenda rezistencën institucionale kundër shpërnguljes së shqiptarëve prej Kosovës. Paknaqësia ndaj regjimit ka qenë e madhe, për shkak të zhvillimit shumë ngadalë ekonomik të Kosovës dhe përgjithësisht n'vitet ku kanë banu' shqiptarët. Kjo ka shkakto' rezistencën tjetër dhe paknaqësia n'rritje ka ardhë pas burgosjes së njerëzve që nuk janë knaqë mrena, dhe kanë vepru' në mënyrë jo t'armatosun por në rezistencë propagandë po. Jone tash, vllau im Sokoli me Adem Demaçin kanë qenë. Kadri Kusari, si e pat emrin Ismail Dumoshi e tjerë, e tjerë që kanë qenë. Në një takim të rastit që Fadili e ka pasë aktivin politik t'Gjakovës, ka rrjedhë informacioni – se meritë ma e madhe e një hovi ma t'madh të zhvillimit të Kosovës e kanë t'burgosurit politik. Për shkak se nuk ka pasë burg në Jugosllavinë... ish-Jugosllavinë. Nuk po përmendi persona, personalitete, ku nuk ka pasë t'burgosun shqiptarë. Qikjo!

Në familjen tonë vllau jem ka qenë n'burg – nantë vjet. Sokoli ka qenë gjashtë vjet e gjysë i dënum, Moslimi njëmdhetë vjet. Na kemi qenë ka pak, mu m'kanë marrë n'biseda informative dy herë ka katër orë, por unë nuk e di as vet, nuk m'kanë burgosë. Shkaqet i kanë ditë ata sigurisht. Por, si familje kemi qenë n'sy t'pushtetit.

Të gjithë pjesëmarrësit në Konferencën e Bujanit kanë pasë ka dikend n'burg. Ka pas prej tyre që edhe janë vra gjatë luftës dhe mas luftës. Për shembull që Pavle Joviçević i qet n'priti forcat e Muharrem Bajraktarit. Vritet Hajdar Dushi, Sadik Pozhegu e do partizanë të tjerë, n'priti. Xheladin Hana ka qenë drejtor i shtëpisë botuse “Mustafa Bakija” ma vonë “Rilindja”, vritet n'burg, n'tortura n'viti 1949. Përpjekjet kanë qenë të them mbinjerëzore, osht' dashtë shumë punë, ndoshta edhe dredhi. Por të gjitha nuk kanë bo pare. Si rezultat i mosbesimit i serbëve dhe malazezëve ndaj komunistëve shqiptarë t'Kosovës, prijës që kanë qenë të Lëvizjes Antifashiste Nacional Çlirimtare, osht' organizu' procesi i Prizrenit. A keni ni për te?

**Jeta Rexha:** Jo, tregona diçka.

**Musa Dobruna:** Procesi i Prizrenit osht' organizu' për likuidimin politik të kuadrit shqiptar, komunistëve shqiptarë n'krye me Fadil Hoxhën. Për secilin kanë bo dosje e mlihet aktivi politik i krahinës atëhere, dhe n'rend dite – problemi i Fadil Hoxhës. Dosja qikaq ka qenë {tregon madhësinë me duar}, edhe për të tjerët.

Qito që po i thomë tash janë fjalët e profesor Ekrem Murtezait akademik, fjalë të cilat i ka thonë Fadili në udhëtim prej Beogradit në Prizren. Ky ka qenë këshilltar i Fadil Hoxhës n'Komitetin Qendror të Jugosllavisë. Erdh momenti i mledhjes, u ulën, filloi diskutimi dhe secili diskutim ishte kundër meje dhe kundër pjesëmarrësve në Lëvizjen... Konferencën e Bujanit, krejt. Dhe, në një moment, u ndala, thashë “Marova!” Qatëhere vendosa, kjo i shkon në atë kryesinë e mledhjes, Dushan Mugoshës i thotë, “Shok dyq”, shqip, se ai ka ditë shqip mire, “I kom dy fjalë me ty n'katër sy”. Çohet e shkon ai, “Qikjo që e keni organizu' osht' për shkak se unë i thomë nanës nanë, e ti majka. Vetem nuk shkoj. Vetem nuk do t'shkoj!” Po e përfundoj si diçka që çon peshë t'madhe në përpjekjet e njerëzve tanë kundër një regjimi nashta osht' e tepërt me thonë – fashist! Por, qashtu ka ndodhë.

Ndodhën masnej edhe konferencat e tjera. Në një aheng ku isha edhe unë, ishte Fadil Hoxha me shokët e fëminisë, i kishte thirrë n'atë aheng. Kjo ndodhë kur osht' feju' Lini {i drejtohet bashkëshortes}, n'vitet e 90-ta, kur Fadil Hoxhën e patën likuidu' politikisht, e hoqën. Edhe na foli. Po për distancimin tonë prej ngjarjeve t'mëdha të shtetit jugosllav në atë kohë... t'u mos na përfillë. N'anën tjetër n'propagandën botnore gjithmonë kanë thonë se politika jonë e drejtë, konkretizohet mu në raportet me pakica nacionale për Kosovën, mu n'raporte shqiptare. Dhe për çudi t'madhe, mas qatynë deklaratave Shërbimi Sekret i Republikës t'Serbisë i krynte punët e veta. Burgoste njerëz, i merrte n'biseda informative dhe del masanej n'shesh diçka shumë vizionare për mu.

T'u folë për jetën e vet, gjatë kohës t'Jugosllavisë Mretënore, thotë, "Punoja në kantinë të ushtrisë t'kazermave t'Gjakovës dhe," i thotë ai, "baba jem, dikur pasanik i madh, met aq keq materialisht sa e çonte vllaun, 'Kqyr n'munesh me na dhonë naj dinar për me ble bukë, krypë, gaz" petrole, se rrymë s'ka pasë, s'kem pasë rrymë elektrike atëherë (buzëqeshë). "Dhe erdh momenti kur u bo jeta për mu e padurushme," tha, "ika n'Shipni". E n'Shipni e ka kry shkollën fillore n'Shkodër atje, dhe masnej ka shku' n'Shkollën Normale t'Elbasanit. Kjo ndodhë n'kohën e Mretit Zog.

"Nji ditë prej ditësh, po m'thërret drejtori i shkollës Aleksandër Xhuvani" Aleksandër Xhuvani i Madh. "Ulu," tha, "djali jem," e nxurr ni letër tha, "shif çka po shkrun". Shërbimi Sekret Jugosllav ia çon qeverisë së Zogut, një letër në të cilën thotë, "Atje keni komunistë që kanë ikë prej Kosove dhe ata do t'ju qesin ngatërresa. Njeni prej tyre edhe osht' Fadil Hoxha". Ai thotë "Mirë, unë po shkollohem. Çfarë ngatërresa po ju qes juve? Po kqyr punën teme". "Po, po. Po, po djali jem, vazhdo punën. Vazhdo msimin". Edhe e merr atë letër {bën sikur po e futë n'xhep} edhe kurgjo. Ai ka qenë Aleksandër Xhuvani.

Kjo osht' ajo pse rinia e Kosovës kanë ikë n'Shipni – me u shkollu', ose me gjetë mënyrë ma t'mirë t'jetesës. Ktu, une vetëm e marr me mend, ferr ka qenë, vet ferri.

## Pjesa e Pestë

N'fillim t'viteve t'50-ta, nji qëndrim me i thonë, se atëhere kanë ekzistuar ligjet, po osht' punu' simas qëndrimeve jo simas ligjeve që të bahet mobilizimi i fuqisë punëtore nëpër qendrat e Kosovës. Qatëhere, prej Gjakovës kanë shku' rreth tre qind msusë edhe nëpunësia nëpër Kosovë, për me organizu' shkollimin edhe administratën aty-ktu. Dhe ma vonë tash, mu n'vitet e '50-ta prapë ndodhi ajo fjala kur dorëzohej diplloma e maturës e Zeqeria Rexhës t'madh që ka qenë ma i zëshmi kundër regjistrimit të popullatës shqiptare islame si turq për qëllimet antishqiptare për m'i dërgu' në Turqi. Kjo ka ndodhë n'vitet e '50-ta. Me qindëra, mijëra shqiptarë jonë shpërngulë prej ktuhit. Efekti i punës i qatij mobilizimi t'fuqisë punëtore ka qenë shumë i madh, për shkak se ka qenë i madh ndikimi i qatyne gjakovarëve nëpër qato qendra. Nuk ka pasë qendër n'Kosovë ku nuk ka pasë msusë nga Gjakova. Dhe, me e lonë tash me ngritë njerëz pa merita me shpallë hero që ka luftu' kundër Lëvizjes Nacionaliste Antifashiste Çlirimtare, kjo osht' nonsens i madh. Dhe kush? Qata që edhepse e kanë pa që Gjermania po humbë, po bohen me gjermanë, po luftojnë kundër partizanëve. Qikjo ka qenë rasti me Shaban Polluzhën për shembull.

Nji rast, me 12 shtator 1999 m'ka ndodhë nji konflikt që nuk e nisa unë. Me nji civil te Hoteli "Iliria", m'del përpara, m'thotë "Ndalu!" Po ndalem. "Urdhëno?" Tha, "Legitimohu". Thashë, "Nuk po shoh. A ke autoritet me m'nalë, me nalë qytetarë?" E nxurr nji karton që i shkrunte PK në t'kuqe me shkronja t'zeza t'mëdha – PK. Unë po e lexoj thash Policia e Kosovës. Kjo ka t'boj me SHIK-un. Aty kom pas nji kacafytje verbale me ta. Dhe, për me i ikë publikut kah parkingu kom hy n'hotel atje, nuk dojshin me m'lonë me hi te drejtori, po hyna une. Thashë... ai m'qetësoi, dola prej atyhit, po m'presin tre vetë me shajtjet ma t'ndyta që ishin. Edhe une për ni moment i thash, "Eh i mjeri unë mas gati 50 vjete po u dukka me marrë armën edhe me luftu' kundër t'keqes", thashë, "Kom qenë partizan". Tha, "Uh, gjyshi jem," ashtu flliqhtë, "ja u ka kajtë nanën partizanëve". I thashë, "Po unë," me t'njejtën por pa shamje, "Ballit Kombëtar" {tund kokën}. Edhepse kom qenë i bindun se Balli Kombëtar nuk ka qenë antishqiptar, por rrugën e ka pasë t'gabushme. Ata nuk jonë rreshtu' me aleatët e mëdhenj me Shtetet e Bashkume t'Amerikës.

[Bie zirja e telefonit] [...] Qendër e madhe ose e vogël ku nuk ka pasë msusë nga Gjakova. Qikjo ka qenë, kjo n'sajë t'atij organizimit. E kanë shfrytëzu' qëndrimin për mobilizimin e fuqisë punëtore, n'kuadër t'saj kanë qitë msusë, nëpunësia e tjerë. Shojja jeme Hydajetja, osht' transferu' prej Peje në Rahovec hala pa i mushë 17 vjet, 16-17 vjeç, ka punu' si msuse. Masandej, osht' transferu' prej ktuhit me dekret për në Gjilan,

bashkë me axhën e saj Qamil Binxhia. Atje ka punu' pesë vjet si msuse. Dhe përshtypja ka qenë aq e mirë sa s'ka. Po atje bashkë me Qamil Binxhiun e Hydajeten ka qenë Miftar Vokshi për shembull, vllau i Asim Vokshit. Ka qenë Masar Kadia, Dervish Shehu, si e ka pasë emrin ai..., njifar Syka. Edhe plot të tjerë.

Mynyr Sanasi për shembull e kanë çu n'Kaçanik me udhëheqë kursin për aftësimin e kuadrit në kontabilitet, në financa. Ta them si anekdotë tash, t'u pi me vendasit aty me shokët me t'cilët bashkëpunu', n'pije e sipër i thonë, "Hajt me na tregu' a ma t'meqëm jeni ju n'Gjakovë gjakovarët, apo na Kaçaniku?" Mynyr Sanasi ju thotë, "Jo, ju jeni ma t'meqëm se na." "E pse?" "I keni shpijat në vade, e arat mi vade" (qeshë). N'Kaçanik shumë shpesh e merr uji aty. Anekdotë kшту...

**Jeta Rexha:** Qysh jeni taku' me zojën Hydajete?

**Musa Dobruna:** Si?

**Jeta Rexha:** Me shoqën tuj, qysh jeni taku'?

**Musa Dobruna:** Paksa e dhemshme por, osht' çashtja e përcaktimeve t'mija. Kur u hap Shkolla Normale e Gjakovës, ishin tri-katër vajza n'krejt shkollën. Dhe Komiteti vendosë me na thirrë aktivin politik qysh i thojshim n'atë kohë ne, kishte ardhë Xhevdet Hamza pak me vonesë deri sa erdh dhe tha, "Kom vetëm dy-tri fjalë me t'i thonë. Ju po e shifni se populli nuk po i çon vajzat në shkollë. E unë po ju thom kështu, që i kqyrni me sy të t'riut," n'atë kohë po edhe sot kështu (buzëqeshë), "jo që ju përjashtoj prej shkolle, por n'burg. A morret vesh?" Qikjo ishte e fundit. Dhe unë i jom bindë prindërve t'mi që ata me ma zgjedhë shoqen e jetës. Unë nuk e kom përjetu' atë jetën e adoleshentit ose të riut, edhe as t'rejat. Edhe kemi mrrri që Shkolla Normale të ketë ma shumë femna se sa mashqi. Kjo osht'. E kjo osht' prapë angazhimi i komunistëve shqiptarë.

Masanej edhe diçka tjetër që ka shumë randësi, por për Gjakovën. Organizohet dhe hapet Shkolla Normale për amvisë. Vijnë prej krejt Jugosllavisë, 95 përqind t'tyne kanë qenë serbe malazeze e t'Bosnjës, Maqedonisë e tjera, tjera, prej Vojvodinës e tjera. Qëllimi ka qenë t'martohen n'Gjakovë. Asnji s'osht martu' n'Gjakovë, nuk e kanë mrrri. Nji osht' martu' për nji serb dhe ajo o' nda mas nji kohe. Qikjo osht', qikjo o' karakteristika e... po flas për atë kohë për Gjakovën.

N'trollin e kazermave n'Gjakovë osht' ndërtu' Shkolla Normale, shkolla për msusë. U hapën themelet edhe masnej u organizun me shku' me bo mallter, me bajtë tulla, zall, ne, nxanësit e shkollës. Dhe u ndërtu' Shkolla Normale. S'paku dy here n'javë Xhavit Nimani, Zeqeria Rexha, Fadil Hoxha vijshin me pa sesi po zhvillohen punimet. Dhe, kjo ndodhi n'vitin 1946 që zgjati deri n'vitin 1953 kur Shkolla Normale e Gjakovës, shpërngulet për në Prishtinë, dhe atëhere ka vazhdu' puna.

A din çka ndodhë diçka shumë interesant? Tendencat e hegjemonizmit serb bohen që pjesa dërrmuse e landëve në Normalen e atëhershme dhe Kursin e Naltë Pedagogjik të t'rritunve të zhvillohen në gjuhën serbe. Atëhere ndodhë që Ali Hadri e bon n'mënyrën e tij organizimin e nji shtrajku të nxanësve. E bojkotojnë msimin. Merr vesh Fadil Hoxha n'Beograd të cilin deri vonë nuk e kanë lonë me ardhë n'Kosovë siç ka ndodhë me nji plejadë njerëzish, thjeshtë s'i kanë lonë me ardhë n'Kosovë... dhe me ju folë nxanësve që m'u kthy n'msim. Na thirrën, shkumë edhe na tha kështu, "Trusni, dhe msoni. Kur t'bëhi ju, kta që kanë ardhë prej Beogradit kthehen n'vend t'vetin e ju i merrni punët n'dorë. Mos t'kishin qenë kta, na do t'ishim detyru' me marrë prej botës t'jashtme njerëz për aftësimin e fmive tonë nëpër shkolla". {I drejtohet shoqes} Fjalët e Ramadanit. M'fal.

Nji profesor po e vetë, ato që e ka pasë pranë, "Çka po thotë te Fadil Hoxha?" "Po thotë qështu..." "Po aii... po da, imamo pravo," ai ka t'drejtë, t'drejtë po thotë. Kur t'bëhi ju, i merrni dhe i zhvillon msimet n'gjuhën e ju. Dhe kthehen nxanësat e vazhdon puna. N'qat kohë Zeqeria Rexhën e përzen prej ktuhit pse ka qenë

ma i zëshmi n'luftë kundër qëndrimeve për shpërnguljen e shqiptarëve prej ktuhit, dhe regjistrimin e shqiptarëve të besimit islam në turq.

[I intervistuari flet për Lidhjen Demokratike të Kosovës, fillimi i rrëfimit s'është xhiruar me kërkesë të folësit][...] u formu' si lëvizje për të drejtat e shqiptarëve në Jugosllavinë e atëhershme. I osht' ofru' që Fehmi Agani të jetë në krye të saj por nuk e ka pranuar për shkak se shumë shpesh ka qenë në biseda informative në Sekretariatit e Punëve të Mrenshme, dhe ai ka qenë gati i përjashtum prej sistemit arsimor në Universitet, dhe nuk ka deshtë. Por ka qenë truni dhe zemra e Lëvizjes, Lidhjes Demokratike të Kosovës që osht' regjistru' në organet federative n'atë kohë dhe ka vepru' në mënyrë legale. Kryetar o' zgjedhë krejt rastësisht, Ibrahim Rugova, por Ibrahim Rugova ka qenë intelektual, njeri që e ka afirmu' çashtjen e Kosovës n'botë. Pak ma përpara thash që e ka zgjanu' gjeografinë e fjalës shqipe nëpër botë, edhe çashtjen e Kosovës. Për krejt çka ka ndodhë, n'kuadër të vet Lidhjes Demokratike, atje kanë qenë... kanë qenë qata njerëz të cilët Fehmi Aganin e kanë respektu' skajësisht. Por, tash rrallë përmendet. Kanë pësu' disa ndryshime aty po, jemi njerëz dhe (buzëqeshë), kem mundësi me ndryshu' pak (qeshë).

Qysh thotë Fridrih Niçe, "I ngjashëm me mu osht' ai që ndërron", kuptohet n'kontekstin pozitiv. Ndërron edhe mendësia e ktyne njerëzve tanë. Kadale, po me siguri ka me ndërru' dhe na do t'ja mbërrijmë (buzëqeshë). Ashtu.

Me iniciativën e Fadil Hoxhës bahet ndërtimi i bustit, i kësaj të Hysni Dobrunës qatje o' fotografia {dëfton kah fotografia}. Ky ka qenë një prej komandantëve të kompanive atje gjatë Luftës t'Dytë Botnore si partizan. E si nëpunës ka punu' n'Vuçitërnë. Prej atyhit ka dalë partizan. Ka qenë njeri i urtë, si i ri as kurrë nuk u zonë me shokë. Por ku ka ardhë momenti, e ka rrokë pushkën dhe ka dalë n'mal. Dhe vritet në ditëlindjen e tij me 16 tetor 1944 n'Junik. Mas Luftës t'Dytë Botnore me iniciativën e Fadil Hoxhës, bohët busti. E kom edhe fotografinë kur e ka zbulu' Fadil Hoxha. Edhe mas luftës së UÇK-së, ia hekin përmendoren n'Junik, dhe ia vejnë emrin e një heroit të UÇK-së.

Na kemi bo njëfar kërkesë kështu verbale, e unë do t'a qes n'gjyq komunën. E kanë hekë bustin e nuk dihet ku osht'. Kryetari i komunës thotë, "E kanë hekë huliganët". Po sigurisht që huliganët e kanë hekë, po ju a keni ndërmarrë najsen me e gjetë ato. Unë do t'a padis komunën! Kjo osht' për keqardhje edhe për ni arsye tjetër. Po u hiqet emri i shkollave të herojëve të luftës antifashiste nacional çlirimtare – Emin Duraku, Hysni Zajmi e tjerë. Gruja një nëpunëse në ambasadën e Kosovës n'Hagë po m'tregon se afër Malishevës, një fshat ashtu e ka hekë emrin e Emin Durakut, ia ka vnu' një luftëtari aty. Unë as që m'shkon menja me e nënçmu' luftën e UÇK-së dhe kishte me qenë marrëzi për mu. Por, a thu Juniku nuk do t'a ndërtojë një institucion tjetër dhe me ia ngjitë emrin e herojve të UÇK-së a? A nuk osht' kjo fshimje e historisë a? Nuk bon! {tund kokën} Po, ça me bo.

## Pjesa e Gjashtë

Mas luftës, me urdhën të Xhevdet Hamzës, sekretar i Komitetit atëhere merret vendimi kështu verbal që unë t'mos shkoj ushtar meqenëse kom qenë partizan. Dhe, une ia u lo organeve me e kry atë punë. Dhe vjen viti 1955 dhe Gjyqi Ushtarak i Nishit vendosë me m'dënu'. Por dënimin me ia lonë si kompetencë kryetarit t'komunës t'Gjakovës, ai me marrë masa çka t'dojnë. Dhe m'thërret një mik i familjes tanë kështu, dashamir deshta me thonë, Qamil Zenuni, dhe m'thotë, "Lexoje qata – Me shku ushtar". E shkeva ato dhe m'ndodhi me shku' me kry ushtrinë. Atje kom hekë t'zitë e ullinit. Kom qenëi njëkun prej bashkëpunëtorëve të KOS-it atëhere, shërbimi ushtarak KOS-i. Po, kom punu' shumë. Nuk e kom lonë... ato dyshimet i kanë pasë, por i kanë pasë sjelljen prej zyrës së mobilizimit n'Gjakovë si njeri i rrezikshëm. Kte ma komunikojnë ata masi t'a kryj ushtrinë. Ma japin atë librezën, por, eprori m'thotë, "Shif çka po



shkrun”, thash “Mu Gjakova m’njeh. Kjo çka po shkrun... {tund kokën}për mu nuk ka kurrëfar rëndësi”. Dhe ndahemi prej atyhit.

Vij n’Gjakovë dhe nuk gjoj punë. Nuk m’japin punë. Po unë po fshehena, ruhesha prej babës mos me ashtu... Nji ditë prej ditësh, “A s’ke me dalë n’msim a?” Thash, “Jo”. “Çka jo?” Thashë, “Po nuk jom n’punë.” “Qysh nuk je n’punë? Pse?” Thashë, “Po m’kanë thanë me bo kërkesë,” thashë “nuk kom shku’ me qef n’ushtri. Venin e punës e kom”. Kom qenë zavendës drejtor i shkollës. I rrëmbyshëm prej asajna, shkon te kryetari i komunës e i thotë, “A je kryetar ti apo Sami Zhuja?” “Pse?” “Qështu e kom punën”. Veç e merr telefonin {bën sikur po ndëgjon me telefon}, “Qitash me ia bo vendimin edhe me emnu n’skollën!” Dhe e filloj punën n’vitin 1957. Jo, po... n’vitin 1954/55. M’fal, a muneni me përmirsu’?

Del libri i teorisë për klasën e tretë fillore. Në hymje të librit thuhet, “T’parët tonë sllavët, kanë ardhë prej Karpateve n’shekullin e kaq,” tekstualisht. Dhe erdh anëtari i Komitetit n’atë kohë me kqyrë se qysh po shkon puna se e zavendësojsha unë. Tha, “A ka far problemi?” Thash “Po”. “Çfarë problemi?” “Qiky libër! Unë këtë njësi metodike nuk e zhvilloj”. Ai m’u përgjigjë tha, “Mos i qit vetit telashe. Si Ibrahim Rugova... (buzëqeshë), Ibrahim Zherka që n’Komitet e ka ngritë këtë punë”. Na nuk jemi sllavë. Ndodhë që OZNA n’atë kohë del e i mledhë krejt librat, ku jonë e ku s’jonë dhe zhduken. Dhe nuk zhvillohet ai msim mo. Prapë na Gjakova e kemi bo ato.

{E merr librin mbi tavolinë} Dhe ndodhë ma vonë edhe qikjo {e tregon librin para kamerës}. Autori osht’ Radovan Zogoviç. Citatet... kto te hymja i thotë, “Autorëve të ktyne vargjeve 1001 herë falemnderit”. Se aq shumë e demaskon regjimin antipopullor, regjimin monarko-fashist të Jugosllavisë së Karagioçëviçëve sa s’ka. E ky o’ malazez, Radovan Zogoviç, shok i Esat Mekulit. Edhe këtë libër UDB-a e ka mledhë nëpër librari edhe... Une i pa ble gjashtë copa, pesë i kom falë, kto e kom rujtë. Osht’ n’dy gjuhët, ja “Došljaci” – “Ardhësit”. Serbët edhe malazezët n’Kosovë jonë ardhës (buzëqeshë). Qishtu.

Jom angazhu’ në aktivitetin për zhdukjen e analfabetizmit, sidomos të grave. Shkrim e lexim n’jetën time kom msu’ bashkë me nanën time. Dhe n’atë kohë m’bjen n’dorë “Bleta Shqiptare”, nji revistë e përkohëshme e lidhun, numrat e nji viti, a dy, a tri. N’kuadër t’asajna biografia e Helen Keler. E lindur e verbër edhe shurdh-memece, bijë e nji pasaniku t’madh amerikan. N’moshën tetë vjeçare ia marrin pedagogën, ia goditin pedagogën me e msu’ alfabetin e hebrejit dhe emrat e kuptimit dhe emrat konkretë. I mson krejt kto, dhe n’fund, çka osht’ Zoti. Simas bindjes dhe t’kohës pedagogia i thotë se Zoti osht’ fuqi e mbinatyrshe që ka kriju’ yjet, diellin, hanën, tokën. Dhe n’tokë, masi i ka kriju’ të gjitha t’mirat materiale t’ekzistencës e ka kriju’ njeriun si qenien ma t’dashun. “Mirë,” tha “ju keni sy me shiju bukurinë e natyrës” i thotë tash pedagogës n’moshën 12 vjeçare. Tha, “Po”. “Une s’kom. Keni veshë me ndigju simfoninë e zogjëve nëpër pyje n’natyrë”. “Po”, “Une s’kom. Keni thonë se Zoti osht’ i plotfuqishëm, pse ka leju’ që unë t’jem kështu, s’jom si ju”. Ia la fajin prindërve dhe rrethanave.

Ju i keni kto aftësishtë, shqisat për me i shiju’ krejt kto, unë nuk i kom. Thotë, “Faji o’ i prindërve dhe rrethanave. Pse i ka leju’ prindët? Keni thonë që osht’ i gjithfuqishëm, dhe keni thonë edhe për jetën keni folë. Njeriu lind, zhvillohet, plaket, dhe vdes. Pse me vdekë? Dhe pse me mos me rrnu gjithmonë, dhe gjithmonë i ri, e re?” Tash përgjegja t’i themi logjike e pedagogës osht’, “Bota kishte me u bo shumë e vogël dhe kishin me ngja lufta, konflikte mes t’njerëzv, si krymat”. “Ah,” thotë, “Zoti i plotfuqishëm, pse i lejon ato? Dhe pse i lejon luftat? Dhe n’qoftëse shumëzohen aq shumë njerëzit, pse s’pe bon edhe nji botë tjetër? Keni thonë se për shtatë ditë i ka kriju’ tona kto”. Dhe msusja shkon te prindërit dhe i thotë, “Une ate mo s’kom çka e msoj. Ajo din ma shumë se unë”.

Helen Keler vdes n’vitet ’70-ta, Doktor i Filozofisë në vitin 1903. Vdes si komisare e lartë e Kombeve të Bashkume për ndihmë t’njerëzve me aftësi të kufizuara. Prej asaj kohe une nuk besoj mo. Edhe nuk besoj edhe për nji arsye tjetër se islamini qitu na e ka pru’ osmanliu me shpatë e barut. Dhe, nuk kom pa

përgjigje prej çarqeve kulturore edhe shtetënore të Turqisë. Pse? Të gjithë popujve të tjerë rreth shqiptarëve ju kanë leju' shkollat në gjuhën e tyre, e shqiptarëve jo. Kurrëfar simpatije nuk kam ndaj osmanliut. As ndaj islamit. M'fal nëse godis ndjenjat e juja. Qashtu.

**Jeta Rexha:** Zotni Musa, cilat mendoni që kanë qenë arritjet e tua ma t'mdhaja edhe andrrat e tua sa jonë realizu'?

**Musa Dobruna:** Andërr... njëra prej andrrave t'mija ka qenë dhe mbetet hala shkollimi i fmise të mi të cilët e kanë kry, dhe i gjeneratave të matutjeshme. Kurgjo tjetër. Qikjo o' andrra ime (buzëqeshë). Dhe mund t'ma shohin për t'madhe Halil Matoshi por une e du' bashkimin kombëtar. Unë nuk jom nacionalist n'atë që i urren popujt e tjerë.

Jemi populli ma i vjetër n'Ballkan. Jemi popull që t'parët e kemi përqafu' krishterizmin se kemi qenë robë të romakëve. Dhe prej qatye ilirëve dalin personalitete shumë t'mëdha që kanë lonë gjurmë n'kohë. E ke pasë Dioklecianin që edhe sot ekziston n'Split pallati i tij dhe për shembull, me në saje të angazhimit të Ramadan Sokolit, hulumtus shkodran, gjejmë që kompozitor i parë i hymnit që knohet sot nëpër kishat katolike ka qenë ilir, Niket Dardani. Edhe masnej vijnë me radhë, ndahet Perandoria Romake në Perandorinë e Lindjes me kryeqytet Konstandinopojën dhe të Perëndimit me kryeqytet Romën. Dhe të gjitha çka ka ndodhë mas në histori, dihen (buzëqeshë).